



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbajtur më 20.12.2022, duke filluar nga ora 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fiknete Bejta-LDK, kryesuese, Taulant Maxharraj-AAK, Mimoza Xhaka-Bllacaku-eksperte e jashtme.

Në mbledhje ishte prezent edhe Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.  
Munguan: Liridon Selmani-PDK dhe Arbër Vokrri-VV.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fiknete Bejta, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

### Rend të ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale;
2. Raport për punën e komitetit për vitin 2023;
3. Të ndryshme.

Fiknete Bejta, kryesuese konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Fiknete Bejta, kryesuese konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

#### Pika e dytë

Raport për punën e komitetit për vitin 2023

Fiknete Bejta, kryesuese tha se nësi komitetit kemi pasur disa aktivitetet, ju kemi përgjigjur çdo aktiviteti që na ka ftuar Drejtorja e Mirëqenies Sociale dhe Drejtorja e Shëndetësisë gjatë 6 mujorit prej kur e kemi marr mandatin si komitet dhe kemi realizuar disa takime me dy drejtoritë. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi diskutuar për

spitalin e qytetit, me organizatën që është duke e studiuar fizibilitetin, ku dhe ka pasur një informim lidhur me spitalin e qytetit. Po ashtu kemi qenë pjesë aktive në muajin tetor "Prishtina rozë" që ka qenë fushata për sensibilizimin e kancerit të gjirit, kemi qenë aktive dhe besoj se roli jonë është vërejte në këtë fushatë. Pastaj vet fakti që jemi komiteti i vetëm që e kemi plotësuar numrin e mbledhjeve si i kemi pasur në kalendarin e punës, ku i kemi mbajtur gjashtë mbledhje duke e përfshi këtu edhe mbledhjen e konstituimit. Gjatë këtyre mbledhjeve kemi pasur dy raportime të Drejtorit të Shëndetësisë drejtorit Izet Sadiku dhe drejtorja e Mirëqenies Sociale Adelina Sahitit, dhe këto dy drejtori kanë raportuar pasi që mbulohet nga shëndetësia dhe mirëqenia sociale. Pastaj kemi pasur takim me strehimoret e grave, pastaj një tryezë pune, ku ka qenë një konferencë nga ARGOMENS, që ka qenë me titull barazia gjinore, nga ngacmimet seksuale, nga dhuna në familje, kështu që mendoj si komitet në këtë periudhë kohore kemi arritur me i mbuluar disa prej aktivitetet të cilat janë të përcaktuara me ligj.

**Taulant Maxharraj** tha se ne si anëtarë të komitetit kemi qenë pjesë e të gjitha këtyre diskutimeve në mbledhjet e mbajtura, kështu që sa i përket drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë, ka qenë shumë aktiv dhe ka dërguar projekte përpara edhe na vjen mirë dhe besoj se kemi me e mbështetë pa dallime pozitive opozitive edhe vitin tjetër. Kërkoj nga kryesuesja që në emër të komitetit për mbledhjen e radhës së Kuvendit të përgatitet një raport i shkurtër për aktivitetet e këtij komiteti gjatë vitit 2022.

**Fiknete Bejta**, kryesues po ashtu ceku se drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë ka shty përpara disa projekte të cilat veç janë votuar edhe në Kuvend, e njëri prej tyre ka qenë edhe ndërtimi i poliklinikës stomatologjike, projekt i cili është votuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e Kuvendit.

#### **Pika e tretë Tek të ndryshme**

**Mimoza Xhaka** tha se zakonisht vizitat mjekësore bëhen më shumë nëpër shkollat fillore, por edhe ne aty në shkollën ku veç punoj unë e kemi edhe mjekun e shkollës, kështu që kishte me qenë mirë që vitin e ardhshëm me organizuar ndonjë aktivitet që lidhet me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

**Fiknete Bejta**, kryesuese tha se këtë iniciativë do ta parashohim me planin e ri të punës së komitetit, ku në fokus do ta kemi edhe punën e terrenit. Po ashtu tha se do ta përgatis një kalendar të punës dhe do ti vendosim edhe këto aktivitetet, që mos të kemi takime vetëm në zyre.

*Mbledhja përfundoi në orën 16:45.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesja e komitetit  
Fiknete Bejta**



Faqe 2 nga 2